Kronikë

Tiranë/ Përdhunoi 29-vjeçaren, policia arreston të riun, në makinë i gjen kallashnikov dhe kokainë! Në pranga edhe 5 shokët e tij

Gjatë kontrollit në lokal u gjetën të fshehura 1 armë zjarri pistoletë, 1 jelek antiplumb dhe 2 shkopa bejsbolli, ndërsa gjatë kontrollit në automjetin e 31-vjeçarit u gjetën 1 armë zjarri kallashnikov dhe një sasi kokaine.

Redaksia
3 Nëntor, 15:30 | **Përditësimi: 3 Nëntor, 15:50**

Share

Tiranë-Një 31-vjeçar është arrestuar nga Policia e Tiranës pasi dyshohet se ka kryer marrëdhënie seksuale me dhunë me një 29-vjeçare.

I riu, i identifikuar si Armando Mirashi, sipas policisë ka kryer marrëdhënie kundrejt dëshirës me 29-vjeçaren në automjetin e tij, dhe më pas ka shkuar në një lokal ku dyshohet se konsumohej dhe shitej lëndë narkotike.

Në pranga janë vënë edhe 5 shtetas të tjerë, klientë në lokal, për moskallëzim krimi. Ata janë: Armando Mirashi, Ersel Kumrija, Endrit Kumrija, Anesti Prroi, Siciljan Çakraj, Klevi Reka, Anxhelo Hodja

LEXO EDHE:
Ilir Yzeiri: Veliaj fiton lirinë, në ditën kur u shua Fatos Nano

Gjatë kontrollit në lokal u gjetën të fshehura 1 armë zjarri pistoletë, 1 jelek antiplumb dhe 2 shkopa bejsbolli, ndërsa gjatë kontrollit në automjetin e 31-vjeçarit u gjetën 1 armë zjarri kallashnikov dhe një sasi kokaine.

Njoftimi i policisë:

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Several", goditen 2 raste të armëmbajtjes pa leje dhe 1 rast i përshtatjes së lokaleve për përdorimin/shitjen e lëndëve narkotike. Posedonte 1 armë zjarri kallashnikov dhe kokainë në automjet, vihet në pranga 31-vjeçari. Ky shtetas dyshohet se ka kryer marrëdhënie seksuale me dhunë me një 29-vjeçare. Posedonte 1 armë zjarri, 1 jelek antiplumb dhe 2 armë të ftohta, në lokalin e tij, vihet në pranga 24-vjeçari. Vihen në pranga dhe 5 shtetas të tjerë, klientë në lokal, për moskallëzim krimi.

Sekuestrohen 2 armët e zjarrit, municion luftarak, 1 jelek antiplumb, lëndë narkotike, 2 automjete, 7 celularë dhe 2 armë të ftohta. Shërbimet e Komisariatit Nr. 3, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", finalizuan operacionin policor të koduar "Several", si rezultat i të cilit u arrestuan shtetasit:

-Armando Mirashi, 31 vjeç, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe "Marrëdhënia seksuale me dhunë me të rritura";

- Ersel Kumrija, 24 vjeç, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Përshtatja e ambienteve për përdorim të lëndëve narkotike" dhe "Mbajtja pa të drejtë e uniformës";

-Endrit Kumrija, 23 vjeç, Anesti Prroi, 25 vjeç, Siciljan Çakraj, 28 vjeç, Klevi Reka, 24 vjeç dhe Anxhelo Hodja, 26 vjeç, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit". Shtetasi Armando Mirashi dyshohet se ka kryer marrëdhënie seksuale me dhunë me një 29-vjeçare, në automjetin e tij, dhe më pas ka shkuar në lokalin e shtetasit Endrit Kumrija, ku dyshohet se konsumohej dhe shitej lëndë narkotike.

Gjatë kontrollit në lokal u gjetën të fshehura 1 armë zjarri pistoletë, 1 jelek antiplumb dhe 2 shkopa bejsbolli, ndërsa gjatë kontrollit në automjetin e shtetasit Armando Mirashi u gjetën 1 armë zjarri kallashnikov dhe një sasi kokaine. 5 shtetasit e tjerë të arrestuar, të pranishëm në lokal në momentin e ndërhyrjes së Policisë, dyshohet se kanë patur dijeni për këtë veprimtarinë kriminale në lokal, por nuk kanë kallëzuar. Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

S.B/I.M/Shqiptarja.com

TAG: perdhunim | policia e tiranes | Tirane | Anxhelo Hodja | Klevi Reka | Siciljan Cakraj | Anesti Prroi | Endrit Kumrija | Ersel Kumrija | Armando Mirashi

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: 3 Nëntor, 18:39
Kushtetuesja rrëzon qeverinë për shkarkimin e Veliajt, si e vlerësoni?
Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Ylli Pata: Çfarë sjell fitorja e Erion Veliajt?!
Ylli Pata
3 Nëntor, 18:43

Kushtetuesja konfirmon Veliajn si kryebashkiak të Tiranës! Berisha: Vendimi palosi Ramën dhe Begajn
3 Nëntor, 17:36

Trajner i ri me halle të vjetra, Tiranës i mbetet vetëm fanella! Bylisi 'e fundos' 0-2 në kryeqytet
3 Nëntor, 15:51

Erion Veliaj mbetet kryebashkiak, s'ka zgjedhje në Tiranë! Kushtetuesja rrëzon Ramën dhe Begajn, kryetarja Zaçaj votoi kundër! Zbardhet vendimi
Esiona Konomi
3 Nëntor, 15:26

Shkelën lejen, bllokohet ndërtimi i disa vilave në Farkë! Koçiu: Askush nuk është mbi ligjin (VIDEO)
3 Nëntor, 14:35

Manastirliu: Rilindja urbane 2.0, hapësirat e çliruara do të vihen në shërbim të komunitetève në çdo lagje të Tiranës
3 Nëntor, 14:23

VIDEOLAJM/ Me 'look' të ri dhe e buzëqeshur, Monika Kryemadhi paraqitet në SPAK
3 Nëntor, 13:56

Tiranë/ I dënuar për transport të paligjshëm të emigrantëve, arrestohet 26-vjeçari
3 Nëntor, 13:17



Rrugorja e Tiranës me 'dorë të hekurt', bllokon 1462 mjete elektrike! Në pranga edhe 9 shoferë, ishin nën efektin e alkoolit
3 Nëntor, 12:06

Gjyqi në GJKKO për Bardh Spahinë, shtyhet seanca! Shkak mungesa e avokatit! E radhës më 12 nëntor
Keti Banushi
3 Nëntor, 11:21

Rama: UBT, perspektivë e re! 20% më shumë studentë pas bashkëpunimit me BOKU-n e Vienës, ta kthejmë në një universitet rajonal
3 Nëntor, 10:32

Mashtroi një biznes shqiptar përmes e-mail-eve dhe përfitoi 33 mijë euro, 37-vjeçarja rumune ekstradohet nga Gjermania (EMRI)
3 Nëntor, 10:18

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje